

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6729
E mërkurë, 12 tetor 2022
çmimi 0.40 €

Ministri i Jashtëm austriak: Liberalizimi i vizave për Kosovën është afër



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

HISTORIKE | FAQE 3

PËR HERË TË PARË KOSOVA ME TË DREJTË FJALE NË ASAMBLENË E KËSHILLIT TË EVROPËS



Kosova për herë të parë është ulur dhe ka pasur të drejtën e fjalës në sallën plenare të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Pjesë e delegacionit të Kosovës në Këshill të Evropës ishin deputetët Saranda Bogujevci, Arben Gashi, Enis Kervan, Besnik Tahiri dhe Ariana Musliu-Shoshi. Në

fjalimin para anëtarëve të Asamblesë së Këshillit të Evropës, nënkryetarja e Kuvendit të Kosovës, Saranda Bogujevci, ka theksuar se Kosova është ndër demokracitë më të zëshme në rajon, ndërsa ka shtuar se "nuk kemi të ardhme tjetër përveç të jemi pjesë e familjes evropiane"

OPINION

A DO T'I MBIJETOJMË KËTO KOHË INTERESANTE?! F. 6

Behxhet Sh. SHALA - BAJGOR



AKTUALE



ORBAN: MERKELI DO TË MUND TA PARANDALONTE LUFTËN NË UKRAINË F. 2

MEHAJ E JASHARI SHIKOJNË PAJISJE USHTARAKE NË PANAIRIN "AUSA 2022" NË SHBA F. 7

EKONOMI



BANKA BOTËRORE: NGADALËSOHET RITJA EKONOMIKE E KOSOVËS NË 3.1 PËR QIND F. 8

SPORT



BARCELONA SYNON FITORE NDAJ INTERIT PËR T'I RUAJTUR SHPRESAT PËR KUALIFIKIM F. 10



NISMA FRANKO-GJERMANE, 'PA GARANCI' PËR KOSOVËN DHE SERBINË

FAQE 4



SEKUESTROHEN RRETH 100 OBJEKTE NË PRONËSI TË POLITIKANËVE E TË BIZNESMENËVE NË BREZOVICË | FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Orban: Merkeli do të mund ta parandalonte luftën në Ukrainë

BUDAPEST, 11 TETOR - Kryeministri hungarez Viktor Orban ka thënë të martën se ish-kancelarja gjermane Angela Merkel do të mund ta parandalonte luftën e Rusisë në Ukrainë nëse do të ishte ende në zyrë.

Në një organizim të mbajtur në Berlin, Orban ka thënë se Merkeli e ka parandaluar një luftë më 2014, pas vendimit të Moskës për ta aneksuar Gadishullin ukrainas të Krimesë. "Ajo çfarë ka bërë Angela Merkel pas krizës lidhur me Krimenë, ka qenë fantastike", ka thënë ai. Orban, politikan i linjës së djathtë, i cili ka shumë kritikë në qeverinë gjermane të krahu të majtë, është takuar të dielën me Merkelin në kuadër të vizitës së tij në Berlin. Me publikun nuk janë ndarë detaje se për çfarë

kanë diskutuar ata. Përgjatë organizimit të së martës, Orban ka thënë se presidenti amerikan Joe Biden nuk është personi i duhur për t'i dhënë fund luftës në Ukrainë. Sipas tij, momentalisht është e nevojshme një marrëveshje në mes të Shteteve të Bashkuara dhe Rusisë. Mirëpo, sipas tij, Bideni e ka kritikuar shumë presidentin rus Vladimir Putin. Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt.

Presidenti Putin e quan luftën si "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.



Lavrovi: Rusia është e hapur për bisedime me Perëndimin për luftën në Ukrainë



MOSKË, 11 TETOR - Ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov, tha se Moska është e hapur për bisedime me Perëndimin për luftën në Ukrainë, por shtoi se deri më tani nuk ka pranuar ndonjë propozim serioz për negociata.

Gjatë një interviste për televizionin shtetëror rus, Lavrov tha se zyrtarët, përfshirë edhe zëdhënësin e sigurisë kombëtare të Shtëpisë së Bardhë, John Kirby, kanë thënë se Shtetet e Bashkuara janë të hapura për bisedime, por Rusia ka refuzuar.

"Kjo është gënjeshtër. Ne nuk kemi pranuar asnjë ofertë serioze për komunikim", tha Lavrov.

Ai tha se Rusia nuk do të refuzojë ndonjë takim midis presidentit rus Vladimir Putin dhe presidentit amerikan Joe Biden gjatë takimit të ri të G20-s. Kryediplomati rus tha se nëse ka ndonjë propozim për takimin Putin - Biden, Moska do ta shqyrtojë. "Ne vazhdimisht kemi thënë se ne nuk refuzojmë asnjëherë takime. Nëse ka ndonjë propozim, ne do ta

shqyrtojmë", tha Lavrov. Duke komentuar për mundësinë që Turqia t'i ndërmjetësojë bisedimet midis Rusisë dhe Perëndimit, Lavrov tha se Moska ka vullnet që të dëgjojë çdo sugjerim, por tha se nuk mund të deklarohet se këto përpjekje mund të prodhojnë zgjidhje. Lavrov tha se presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, do ta ketë mundësinë t'i paraqesë propozime presidentit rus Vladimir Putin, kur dy liderët të takohen gjatë kësaj jave në Kazakistan.

Raund i ri sulmesh me raketa ndaj Zaporizhias

IEV, 11 TETOR - Një raund i ri sulmesh me raketa goditi të martën qytetin Zaporizhia në jug të Ukrainës, ndërsa numri i të vdekurve nga goditjet e një dite më parë të Rusisë në qytete të ndryshme të Ukrainës arriti në 19.

Të martën raketat ruse goditën një shkollë, një objekt mjekësor dhe ndërtesa banimi në Zaporizhia, tha sekretari i këshillit të qytetit Anatoliy Kurtev.

Shërbimi Shtetëror i Emergjencave ka njoftuar se 12 raketa S-300 goditën objektet publike, duke shkaktuar një zjarr të madh përreth. Një person humbi jetën.

S-300 fillimisht ishte projektuar si raketë tokë-ajër me rreze të gjatë veprimi. Rusia ka përdorur një version të modifikuar për të goditur objektiva në terren.

Paralajmërimet për sulme ajrore u dëgjuan në mëngjesin e së martës në të gjithë vendin, duke bërë që banorët t'u riktheheshin strehimeve pas disa muajsh qetësie relative në kryeqytet dhe shumë qytete të tjera.

Përveç sirenavë të zakonshme, banorët në kryeqytet, Kiev, u zgjuan të martën nga një lloj i ri alarmi në telefonat celularë, që u shoqërua me një paralajmërim me tekst për mundësinë e sulmeve me raketa.

Shërbimi shtetëror i emergjencave ka njoftuar se 19 njerëz humbën jetën dhe 105 të tjerë u plagosën në sulmet me raketa të së hënës që kishin në shënjestër objektet kritike të infrastrukturës në Kiev dhe 12 rajone të tjera. Më shumë se 300 qytete ishin pa energji elektrike, nga kryeqyteti ukrainas deri në Lviv në kufirin me Poloninë.



Shumë nga sulmet ndodhën larg vijës së parë të luftës. Presidenti ukrainas Zelenskyy u

ka bërë thirrje vazhdimisht udhëheqësve botërorë që ta shpallin Rusinë shtet terrorist për

shkak të sulmeve të saj ndaj civilëve dhe krimeve të dyshuara të luftës.

HISTORIKE

Për herë të parë Kosova me të drejtë fjale në Asamblenë e Këshillit të Evropës

Kosova për herë të parë është ulur dhe ka pasur të drejtën e fjalës në sallën plenare të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Pjesë e delegacionit të Kosovës në Këshill të Evropës ishin deputetët Saranda Bogujevci, Arben Gashi, Enis Kervan, Besnik Tahiri dhe Ariana Musliu-Shoshi. Në fjalimin para anëtarëve të Asamblesë së Këshillit të Evropës, nënkryetarja e Kuvendit të Kosovës, Saranda Bogujevci, ka theksuar se Kosova është ndër demokracitë më të zëshme në rajon, ndërsa ka shtuar se “nuk kemi të ardhme tjetër përveç të jemi pjesë e familjes evropiane”

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

STRASBURG, 11 TETOR - Kosova për herë të parë është ulur dhe ka pasur të drejtën e fjalës në sallën plenare të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Pjesë e delegacionit të Kosovës në Këshill të Evropës ishin deputetët Saranda Bogujevci, Arben Gashi, Enis Kervan, Besnik Tahiri dhe Ariana Musliu-Shoshi.

Në mungesë të zërit autentik të Kosovës, pavarësisht prej përpjekjeve të vendeve mike për të qenë në krah, tash Kosova në Këshill të Evropës ka mundësinë për ta treguar shembullin e konsolidimit të demokracisë dhe të drejtave të njeriut.

Kosova më 12 maj të këtij viti ka aplikuar për anëtarësim në Këshillin e Evropës. Deri tash ajo është bërë anëtare e disa organizatave ndërkombëtare, përfshirë edhe ato më të rëndësishme financiare dhe sportive.

Në fjalimin para anëtarëve të Asamblesë së Këshillit të Evropës, nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci, ka shprehur mbështetjen e Kosovës për Ukrainën, e cila po përballet me invazionin rus. Ajo ka thënë se Ukraina dhe ukrainasit janë

përherë në mendjet dhe zemrat e kosovarëve, ndërkaq Kosova për herë të parë, përveç pjesëmarrjes, pati edhe të drejtën e fjalës.

Para të pranishmëve Bogujevci ka deklaruar se i kupton mirë vuajtjet e ukrainasve, pasi edhe vetë është e mbijetuar e një masakre. “Vetë jam e mbijetuar e një masakre gjatë luftës së fundit në Kosovë. Të gjithë ne jemi me ju në këtë luftë dhe shpresojmë që të marrë fund sa më parë dhe drejtësia të triumfojë”, është shprehur ajo.

Më tutje, nënkryetarja e Kuvendit ka thënë se Kosova është ndër demokracitë më të zëshme në rajon, ndërsa ka shtuar se “nuk kemi të ardhme tjetër përveç të jemi pjesë e familjes evropiane”. “Nëse nuk më besoni, mund të vini edhe ta vizitoni Kosovën dhe të bindeni. Kemi edhe vështirësi, përfshirë me fqinjët tanë dhe një të kaluar që nuk ka përfunduar shumë moti. Por, sot, ne flasim për të ardhmen evropiane. Ne si Kosovë dhe të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor jemi Evropë. Nuk kemi të ardhme tjetër përveç të jemi pjesë e familjes evropiane”, ka thënë Bogujevci.

Ajo ka thënë se sot është një moment tjetër me pesë



historike për Republikën e Kosovës, për vendin tonë në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës. “Të gjitha këto arritje në një organizatë kaq të rëndësishme erdhën si rezultat i angazhimit të punës së palodhshme të plotë njerëzve. Disa që shihen e disa që nuk shihen, por që bëjnë punë të palodhshme në prapavijë. Bashkë me ekipe të tëra gjithçka është e mundur dhe me shpresën që sa ma shpejt të jemi anëtarë me të drejta të plota në Këshillin e Evropës”, ka thënë Bogujevci.

Deputeti nga Ukraina, Oleksi Goncharenko, i dha mbështetje të fuqishme anëtarësimi të Kosovës në Këshillin e Evropës, njëkohësisht kërkoi nga 12 vendet anëtare që ta njohin Kosovën. Po ashtu, Oleksi në Parlamentin e Ukrainës ka nisur iniciativën që ky shtet ta njohë

Republikën e Kosovës. Në fund të fjalimit të tij ai në gjuhën shqipe tha: “Kosova është Evropë”. “Këtë dua ta them veçanërisht për Kosovën. Kosova duhet të njihet nga të gjitha vendet e Këshillit të Evropës, ku 12 vende nuk e kanë njohur. Ju drejtohem dhe ju lutemi ta njihni këtë vend si shtet të pavarur siç luftuan ata për të ardhmen e tyre, për pavarësinë e tyre dhe duhet të ulen këtu së bashku me ne, të jenë pjesë e Këshillit të Evropës dhe vetëm kështu ne mund të bëhemi më të fortë. Të gjithë duhet ta bëjnë këtë, ta njohin Kosovën dhe së bashku të ecim përpara”, ka thënë Goncharenko.

Deputeti Besnik Tahiri ka thënë se sot në Asamblenë Parlamentare nisi etapa e re, ku secilit prej nesh na mundësohet diskutimi dhe komentimi i rezolutave dhe dokumenteve që

miratohet me Këshillin e Evropës. “Unë, sot, me Komitetin për Çështjet Sociale, Shëndetësi dhe Zhvillim të Qëndrueshëm, adresova disa tema që ndërlidhen me një raport për abuzimin e fëmijëve. Kërkova që të bëhet një hulumtim i saktë, ku duhet të trajtohet legjislacioni në fuqi dhe nevoja për legjislacion shtesë si dhe aspekti i ndihmës financiare”, ka thënë Tahiri.

E deputeti Arben Gashi ka theksuar se “Kosova për herë të parë ulet dhe e ka të drejtën e fjalës në sallën plenare të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës”. “Kosova jonë e meriton respektin. E meriton vendin e saj në organizatat ndërkombëtare. Kosova është storie suksesi e popullit tonë dhe bashkësisë ndërkombëtare”, ka shkruar Gashi në “Facebook”.

Ministri i Jashtëm austriak: Liberalizimi i vizave për Kosovën është afër

VJEN, 11 TETOR - Ministri i Punëve të Jashtme i Austrisë, Alexander Schallenberg, pas takimit që ka pasur të martën në Vjenë të Austrisë me ministren e Punëve të Jashtme dhe Diasporës së Kosovës, Donika Gërvalla, në një konferencë për medie ka shprehur optimizëm se liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës do të ndodhë në një të ardhme të shkurtër.

Schallenbergu ka theksuar se Austria ka mbështetur Kosovën gjithë, edhe para luftës së Kosovës, në kohën kur diktatori Sllobodan



Millosheviqi shtypte Kosovën. “Na nevojitet edhe nga ana juaj bashkëpunimi dhe besoj se jemi në rrugë të mirë. Nga 24 shkurti bota jonë ka

ndryshuar, pas fillimit të luftës në Ukrainë dhe pasojat e saj ndihen edhe në Ballkan. Ne jemi të kënaqur që Kosova ka marrë qëndrim shumë shpejt

në këtë çështje. Ne të gjithë e dimë se duhet të jemi të kujdesshëm”, ka thënë Schallenbergu. Sipas tij, tash është koha që të

marrim vendime të rëndësishme për Ballkanin. “Brukseli po diskuton statusin e vendit kandidat për Bosnjë-Hercegovinë dhe për liberalizimin e vizave për Kosovën. Është e pakuptueshme pse ka zgjatur aq shumë procesi i liberalizimit të vizave për Kosovën. Të gjitha shtetet e Ballkanit i takojnë BE-së. Unë shpresoj se për një kohë të shkurtër të ndodhë liberalizimi i vizave për Kosovën”, ka thënë ai në një konferencë për medie së bashku me ministren e Punëve të Jashtme dhe Diasporës së Kosovës, Donika



Nisma franko-gjermane, 'pa garanci' për Kosovën dhe Serbinë

PRISHTINË, 11 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, i kanë marrë mesazhet nga nivelet e larta politike dhe diplomatike të Bashkimit Evropian, në veçanti Gjermanisë dhe Francës, për t'iu qasur seriozisht arritjes së një marrëveshjeje ligjërish obliguese ndërmjet dy vendeve, vlerësojnë njohësit e proceseve politike, në Kosovë dhe Serbi, Agon Maliqi dhe Dushan Janjiq. Sipas tyre, këtë e dëshmojnë edhe deklaratat e ditëve të fundit të Kurtit dhe Vuçiqit lidhur me nismën franko-gjermane, e cila në mediet në Kosovë dhe rajon është përshkruar si dokument-propozim që përmban kornizën e re, mbi të cilën do të bisedohet për arritjen e marrëveshjes që do ta zgjidhë kontestin ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Ky dokument-propozim, siç komentojnë ata, Kurtit dhe Vuçiqit u ka arritur përmes këshilltarëve Jens Plotner dhe Emmanuel Bonne, të kancelarit gjerman Olaf Scholz dhe presidentit francez Emanuel Macron.

Ambasada e Gjermanisë dhe ajo e Francës në Kosovë nuk kanë konfirmuar nëse nga ana e vendeve të tyre ka një iniciativë apo dokument-propozim që mund të jetë kornizë e re e

dialogut Kosovë - Serbi për arritjen e një marrëveshjeje ligjërish obliguese, e cila do ta zgjidhte kontestin ndërmjet dy vendeve.

Propozimi franko-gjerman, "udhëzues dhe sugjerues"

Njohësi i proceseve politike, Agon Maliqi, bashkëthemelues i blogut "Sbunker", thotë për "Radion Evropa e Lirë" se deklaratat e Kurtit dhe Vuçiqit, drejtpërdrejt apo tërthorazi, konfirmojnë se ekziston propozimi francezo-gjerman. Por, sipas tij, ky propozim nuk duket të jetë i detajuar krejtësisht, por jep një kornizë të përafërt të asaj që është e mundshme. "Dokumenti më shumë është si udhëzues, si sugjerues dhe palët po kapen për elementet e saj, për sfera që duken të dobishme në këtë moment për komunikim strategjik. Kosova besoj që ndoshta sheh hapësirë për optimizëm, për faktin se në këtë formulë ku, sipas të gjitha gjasave, nuk parashihet njohja e drejtpërdrejtë, por më shumë implicite - ulet edhe presioni për Kosovën për ta bërë ndonjë kompromis të madh në lidhje me Asociacionin [e komunave me shumicë serbe]. Kështu që,

ndoshta aty [në dokument] Kosova e sheh një lloj hapësire për një marrëveshje që së brendshmi mund të jetë më e pranueshme", thotë Maliqi.

"Testim për ta definuar zgjidhjen përfundimtare"

Dushan Janjiq nga Forumi për Marrëdhënie Etnike në Beograd thotë për "Radion Evropa e Lirë" se që nga nënshkrimi Marrëveshjes së Brukselit në vitin 2013 janë zhvilluar përgjithësisht bisedimet teknike. Por, sipas tij, dokumentpropozimi franko-gjerman synon që dialogun ta ngritë në nivelin krejtësisht politik. "Është lëshuar vetëm si një testim i çështjes - nuk e di se me marrëveshjen e kujt është bërë kjo - pra, të çështjes së statusit, çështjes së definimit të zgjidhjes përfundimtare. Dhe, ajo sillet nëpër opinion. Unë, me sa di, ka mjaft çështje brenda, përndryshe kjo letër do të ishte e padobishme. Së pari, duhet ta dimë se kjo letër bart qëndrimin e Gjermanisë dhe Francës. Për të duhet të deklarohen Prishtina dhe Beogradi, por do të shohim reagime edhe të Britanisë (së Madhe). Do të ishte ideale që një ditë, nga ky proces, të shndërrohet në platformë të përbashkët për negociatë", thekson Janjiq.

Iniciativë apo dokument-propozim?

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, më 10 tetor, ka deklaruar se ekziston "një iniciativë franko-gjermane, e cila dëshiron që t'i japë edhe më shumë fuqi (të dërguarit të Posaçëm të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçakut, sikurse që i jep edhe mbështetja e vazhdueshme amerikane". "Diskutohen modele të ndryshme, por nuk ka diçka përfundimtare dhe aq më pak vendimtare që do të mund të thuhej se ky është propozimi francezo-gjerman dhe rrjedhimisht 'diskutojeni tash dhe jepni vërejtjet. Më shumë ka, si të them, ide që qarkullojnë, Berlin, Bruksel, Uashington, por edhe Londër, Romë e Paris, si dhe Beograd dhe Prishtinë", tha Kurti dhe shtoi se për shkak të konfidencialitetit të bisedimeve, nuk mund t'i hedhë në opinion idetë, me të cilat testohen palët nga zyrtarët dhe diplomatët e ndryshëm.

Një ditë më herët, më 9 tetor, Kurti kishte deklaruar se është optimist që në muajt vijues do të mund të arrihet një marrëveshje ligjërish obliguese me Serbinë. Ndërkaq, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, më 8 tetor

kishte thënë se arkitektura e dialogut po ndryshon në esencë për shkak se kemi në tavolinë propozimin e dy fuqive më të mëdha evropiane, Gjermanisë dhe Francës".

Franca dhe Gjermania, siç ka theksuar ai, kanë propozuar që Serbia ta lejojë Kosovën të anëtarësohet në institucione dhe organizata ndërkombëtare, përfshirë Kombet e Bashkuara, në këmbim të anëtarësimit të shpejtë të Serbisë në Bashkimin Evropian. "Për Serbinë, për shkak të Kushtetutës, por jo vetëm për shkak të saj, është e papranueshme që Kosova të bëhet anëtare e OKB-së dhe kjo do të bartë pasojat e veta", ka thënë Vuçiq.

Më 9 nëntor ministrja e Punëve të Jashtme e Kosovës ka thënë se deklarata e Vuçiqit rreth ulësës në OKB për Kosovën nuk është e vërtetë, sepse propozimi francezo-gjerman "është i ndërtuar me një qëllim krejtësisht tjetër" dhe "është vetëm bazë për të biseduar".

Maliqi: Kosovës nuk i garantohet ulësja në OKB

Njohësit e proceseve politike vlerësojnë se propozimi franko-gjerman mund të shihet "me një dozë të matur të optimizmit" se

Kurti e Haradinaj reagojnë për sulmet brutale të Rusisë mbi zonat civile në Ukrainë

PRISHTINË, 11 TETOR - Kryeministri Albin Kurti u është bashkuar Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian në reagimet e tyre për dënimin e sulmeve të Rusisë në disa qytete të Ukrainës. Kurti në "Twitter" ka shkruar se çdo shtet që kërkon

bashkëpunim me Rusinë është bashkëfajtor për pasojat e pushtimit rus në Ukrainë. Ai ka theksuar se bota demokratike duhet të reagojë, të flasë me zë për sulmet brutale në zonat civile.

"U bashkohem Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA)

dhe Bashkimit Evropian (BE-në) dhe aleatët tanë të tjerë në dënimin e sulmeve brutale të Rusisë në zonat civile në të gjithë Ukrainën. Sot bota demokratike duhet të flasë me një zë: Çdo shtet që kërkon bashkëpunim me Rusinë në mes të kësaj lufte të tmerrshme është bashkëpunëtor

në pasojat e saj", ka shkruar Kurti. Për sulmet brutale të Rusisë në zonat civile në Ukrainë ka reaguar edhe ish-kryeministri Ramush Haradinaj. Ai ka theksuar se sulmet brutale të Rusisë mbi zonat civile në Ukrainë janë skena tmerrri të krimeve të vazhdueshme të

Putinit dhe ushtrisë së tij. "Jemi bashkë me aleatët dhe partnerët tanë në dënimin e këtij akti makabër. Ata që sot nuk janë kundër Rusisë, ata janë me Rusinë. Lutemi dhe bashkëndiejmë me Ukrainën", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".



mund ta lëvizë përpara procesin e dialogut Kosovë - Serbi drejt një marrëveshjeje që zgjidh kontestin ndërmjet dy vendeve. Agon Maliqi vlerëson se në konstelacionin aktual ndërkombëtar, Serbia nuk ka hapësirë t'i rezistojë presionit të Perëndimit pa mbështetjen e mjaftueshme të Rusisë, e cila ka pozicion pas pushtimit të Ukrainës.

Po ashtu, sipas tij, Kosova e ka të pamundur të ecë përpara në integrimet evropiane dhe organizata ndërkombëtare pa mbështetjen e Perëndimit. Këto situata, siç thotë ai, mund t'i detyrojnë liderët e të dy vendeve që ta hapin mundësinë për një proces politik që çon drejt një marrëveshjeje. "Sfida kryesore e këtij propozimi ndërkombëtar është se ai bazohet në shumë supozime dhe rrethana hipotetike, që kanë të bëjnë

sidomos me garancitë e ndërmjetësuesve. Pra, në asnjë rrethanë, sidomos sikurse kjo e sotmja, Kosovës nuk mund t'i garantohet ulësja në OKB, sepse aty nuk është çështja vetëm te Serbia, por aty është Rusia dhe Kina. Ndërkohë, Serbisë nuk mund t'i garantohet përshpejtimi i hyrjes në BE, sepse për hyrje në BE nuk është kushti i Kosovës i vetmi, por ka të bëjë edhe me standardet e qeverisjes dhe me reformat", vlerëson Maliqi.

Janjiqi: Modeli i dy Gjermanive, s'ka ofertë më të mirë

Dushan Janjiqi shpreh mendimin se në dokument-propozimin franko-gjerman "nuk ka hapësirë për tregti, siç kalkulon Vuçiqi para opinionit", se në rast se Serbia pranon

propozimin, atëherë i përshpejtohet anëtarësimi në BE. "Mendoj se ky është fillimi i fushatës që të pranohet ky model. Cili është ky model? Disa e quajnë si modeli i 'dy Gjermanive' dhe kjo është e mira e kësaj letre. Mendoj se në këto rrethana as Prishtina dhe as Beogradi nuk do të marrin ofertë më të mirë. E ajo është që Serbia ta pranojë ekzistencën e Republikës së Kosovës. Pra, që Serbia të mos e pengojë anëtarësimin e Kosovës (në organizata ndërkombëtare) dhe të bashkëpunojë me Kosovën, kur kanë interesa të përbashkëta në organizatat ndërkombëtare, duke përfshirë edhe Kombet e Bashkuara", thekson Janjiqi. "Modeli i dy Gjermanive" nënkupton marrëveshjen e arritur në vitin 1972 ndërmjet ish-Republikës Federale të Gjermanisë (që njihet si

Gjermania Perëndimore) dhe ish-Republikës Demokratike të Gjermanisë (që njihet si Gjermania Lindore). Përmes kësaj marrëveshjeje, të dy vendet normalizuan marrëdhëniet, pa e njohur formalisht njëra-tjetrën. Janjiqi thekson se, megjithatë, nuk pret që së shpejti të ketë ndonjë takim ndërmjet Kurtit dhe Vuçiqit në Bruksel, përveç në rast se Bashkimi Evropian detyrohet të organizojë një takim të tillë. Shkas për një takim të tillë të detyruar, sipas tij, mund të jenë tensionet eventuale në veri të Kosovës në rast se nuk arrihet një marrëveshje teknike për tregat ose nuk shtyhet zbatimi i vendimit të Qeverisë së Kosovës për këtë çështje. Qeveria e Kosovës ka dhënë afat prej 1 shtatorit deri më 31 tetor që të gjitha automjetet në Kosovë, që kanë targa të lëshuara nga

Serbia, me akronimet e vendbanimeve të Kosovës, t'i reregistrojnë ato me targa RKS (Republika e Kosovës). Dialogu Kosovë - Serbi ka nisur në Bruksel, në vitin 2011, fillimisht për çështje teknike, për të evoluuar më pas, në vitin 2012, në dialog politik. Qëllimi i dialogut që lehtësohet nga Bashkimi Evropian është normalizimi i plotë i marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve.

Kryeministri Kurti dhe presidenti Vuçiq janë takuar për herë të fundit në Bruksel më 18 gusht. Palët kanë dallime të mëdha sa i përket përfundimit të procesit të dialogut. Kosova kërkon që një marrëveshje përfundimtare ta përfshijë njohjen reciproke, ndërsa Serbia ka thënë se dëshiron një zgjidhje kompromisi, pa specifikuar se çfarë do të nënkuptonte një zgjidhje e tillë.

A do t'i mbijetojmë këto kohë interesante?!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

As ekonomi, as politikë e as dinjitet përfaqësues: Jemi duke jetuar në kohë të krizës globale. Lufta në Ukrainë e ka përkeqësuar këtë krizë edhe më shumë. Duket se nuk do të ndalet dhe se recesioni ekonomik do të zhvillohet me një metastazim shkatërrues. Në Kosovë, së paku deri më tani, më lehtë po e përballojmë krizën për faktin se lindim në krizë, rritemi në krizë dhe vdesim në krizë. Edhe buxheti i Kosovës është thuaja simbolikë krahasuar me vendet e zhvilluara. Buxheti i Kosovës është i barasvlefshëm me klauzolën e lirim të parakohshëm të Pedrit, lojtarit të Barcelonës (1 miliard euro), të ardhurat vjetore të Mbapes, Mesit, Halandit dhe Ronaldos. Këtu përfundon tregimi sa i përket kapacitetit zhvillimor të Kosovës në kushte normale e lëre më në gjendje krize e që ka karakter të përgjithshëm botëror. Qeveria Kurti 2 e ka marrë qeverisjen në kohën më të keqe të mundshme kur kriza kishte marrë theqafjen, pandemia kishte futur botën në arrest shtëpiak dhe destabilizimi, në këto rrethana ishte përcjellës i natyrshëm. Pastaj, kryeministri Kurti nuk arriti ta ketë një qeveri gjysmëfunktionale e lëre më të përgatitur të përballet me sfidat e rënda me të cilët po përballemi. Po flitet për një zhvillim të jashtëzakonshëm ekonomik prej thuaja 11 për qind e ky zhvillim ka ngjarë të ketë ndodhur pas hapjes nga pandemia kur zhvillimi ishte në vdekje klinike. Po flitet për punësim të thuaja 40 000 qytetarëve të Kosovës në kohën kur të dhënat e Bankës Botërore flasin për një stagnim të madh të zhvillimit ekonomik në Kosovë, kurse njëra prej shkaqeve kryesore konsiderohet papunësia e madhe dhe mungesa e investimeve. Kryeministri me këmbëngulje po vazhdon të flasë për këtë zhvillim të paparë, për një demokraci në Kosovë që nuk e ka shoqen në Ballkan, për hapje të

vendeve të punës në kohën kur radhët për të caktuar një termin për viza në ambasadat e huaja është qindra metra e gjatë, pritjet me muaj të tërë për një termin, përsheptimi i caktimit të terminit paguhet me qindra mijëra euro, individët dhe agjencitë për punësim jashtë vendit kanë punë më shumë se Enti për Punësim i Kosovës dhe kur të rinjtë gjejnë rrugë e rrugë për t'u larguar nga Kosova, madje edhe përmes lumit Rio Grande që është kufiri midis Meksikos dhe ShBA-së, për të siguruar një vend pune apo një perspektivë tjetër, më të mirë se që e kanë në Kosovë. Me padurim po presin liberalizimin e vizave pas së cilës në Kosovë do të përsëritet dukuria që ndodhi në Japoni dhe Kinë; në mungesë të fuqisë punëtore është shtyrë koha e pensionimit sikur që të pensionuarit po kërkohen të kthehen në vendet e tyre të punës. Kosova po rrezikon të mbetet pa pjesën më vitale të saj, pa të rinjtë që më të madhe, ose janë larguar nga Kosova, ose nuk zgjedhin mjete dhe rrugë për t'u larguar. Si shpëtim për ta dhe për familjet e tyre. Për më keq, Kosovën nuk po e braktisin vetëm ata që nuk qëndrojnë mirë ekonomikisht, por edhe ata që e kanë një mirëqenie të qëndrueshme. Është krijuar një pasiguri dhe mungesë e besimit, në të gjitha nivelet. Tash, pasi e provuan edhe demokracinë e Vetëvendosjes që ka filluar të shndërrohet në një keqeverisje, votuesit janë në hall të madh për kënd të votojnë sepse alternativat e reja janë mundësi të provuara më parë kurse, në skenën politike nuk është ndonjë forcë politike që dallon nga e kaluara dhe nga këta të sotmit e që do të garantonte ndryshim të pamanipuluar nga interesat e grupeve të interesit, politike dhe të tjera.

Në rrafshin politik jemi edhe më keq se në ekonomi, zilama të skajshëm. E kemi një qendër të absolute me tendencë të shndërrimit në qendër

të absolutizimit rreth së cilës sillen, si satelitë të kurdisur ministra dhe deputetë, injorantë e shkuar injorantëve, të paafte për ta drejtuar procesin e tredhjes së qenve e lëre më punë të shtetit. Për çudi, nuk ka asnjë shkarkim përveç ndërrimit të vendeve. Kurrë nuk ka pasur raport më të fortë klientelistë, nepotizëm në punësim dhe shfrytëzim të mirave materiale se që ka tani. Kurrë nuk ka pasur rehabilitim më të madh të pasardhësve të atyre që kanë punuar kundër shqiptarëve se që ka tani; fëmijë të ish-funksionarëve komunistë në shërbim të Jugosllavisë dhe Serbisë janë ambasadorë, fëmijë të ushtarakëve të ish-Jugosllavisë dhe të Serbisë, anëtarë të KOS-it (Shërbimi Kundërinformativ Ushtarak) janë në përfaqësi diplomatike, këshilltarë politikë dhe udhëheqin OJQ. Fëmijë të ish-udbashesve të Jugosllavisë dhe Serbisë janë analistë të shquar, pronarë të medie, auditorë në disa ministri dhe kryetarë të Bordeve. Fëmijë të ish-hetuesve policorë (kriminelëve), prokurorëve dhe gjykatësve të ish-regjimit, zgjedhin me kokallë vendet e tyre të punës! Vrasës të ushtarëve shqiptarë dhe ata që dënuan me shekuj ushtarë shqiptarë në ish-Jugosllavi, zënë vend të merituar dhe fëmijët tanë duhet ta ulin kokën para tyre, ndërsa ne që iu kemi keqtrajtuar mizorisht nga ta mendojmë se po jetojmë në ëndrra. Kemi një Grup Teknik për Bisedime si mercenarë të Legjionit të Nderit e që dallojnë nga ta se janë frikacakë dhe të pandershëm! Ata që e bënë luftën dhe që e sollën këtë situatë sot po mbahen peng në Llogoren e Gjykatës së Hagës, kurse këta që dikur ishin kundër tyre po bëjnë spote idioteske për ta përforcuar kauzën e Dik Martit. Kjo është vija politike e brendshme që po zbatohet në Kosovë, kurse ajo e jashtme është përpjekje për servilizëm të padinjitetshëm. Do të

pyesni nëse ka servilizëm të dinjitetshëm?! Nuk ka por, nëse disa veprime i ndërmerri shkak i rrethanave që nuk mund të shmangen, atëherë konsiderohet si servilizëm i dinjitetshëm. Kurse nëse serviloseni për të ruajtur pushtetin me çdo kusht, të cilin edhe ashtu nuk e keni sepse servili ia delegon pushtetin atij që i servilohet, atëherë është servilizëm i padinjitetshëm. Më tregoni se kush e përmend sot komandantin legjendar Adem Jasharin përveç ditës së përkujtimit e që bëhet për shkaqe të përfitimit politik. Edhe Ibrahim Rugovën më shumë po e nderon kryeministri Kurti se Baballarët Themelues të LDK-së. Në këtë kontekst Baca Adem Demaçi qëndron më së miri; nuk po e përmendin as këta të LDK-së, e as partia shtet e IV-së. Prandaj, e them se Albin Kurtit, herët a vonë do t'i vijnë faturat e Bacës Adem Demaçi. Politika e Jashtme e Kosovës nuk është asgjë tjetër veç servilosje dhe kërkesë mëshire, duke i denoncuar këta që e sollën lirinë po përpjekin të fitojnë respekt të atyre që vrasin dhe kthjellin! Nuk janë të zotët të bëjnë asgjë, prandaj kërkojnë mëshire, kërkojnë njohje, kërkojnë që Serbia të ndalë çnjohjet, kërkojnë investime të pamerituara, kërkojnë anëtarësim në NATO, BE, Këshill të Evropës, Interpol dhe institucione të tjera duke bërë përpjekje që të hyhet dhëndër me rekuizite të të tjerëve. Kërkojnë liberalizim të vizave dhe ende pa u marrë ndonjë vendim i marrin meritat për vete duke sulmuar të tjerët për mosliberalizim. Kërkojnë të bombardohet Rusia, Serbia, Kina, Irani, Takhikistani dhe Leshistani, ndonëse nuk i pyet askush dhe për asgjë! Madje presidentja e kryeministrit Kurti kërkon që të bëhet presion ndaj Erdoganit sepse vetëm ai, po të dojë, do ta bindë Vuçiqin ta njohë pavarësinë e Kosovës. Dhe pas kësaj, me kompetencë vazhdon ta quajë veten

president! Jo vetëm kryeministri, por edhe vartësitë e tij (të gjithë janë thuaja të tillë) po vuajnë nga ndjenja e madhështisë së të qenit faktorë në kohën kur, jo që nuk janë të tillë, por shërbejnë si objekt talljeje edhe nga një apartaçik minor si puna e proserbit; Mirosllav Lajçak, në mes të tjerëve! Po thirren në partneritet të përjetshëm dhe po kërkojnë përkrahje edhe kur iu thuhet se duhet të marrin vendime të dhimbshme dhe të vështira, si Serbia ashtu edhe Kosova. Luftën nuk po e bëjnë me Serbinë, por me kundërshtarët politikë brenda në Kosovë dhe me pengjet e Gjykatës Raciste Speciale në Hagë ndonëse nuk kanë asnjë rrezik nga opozita kosovare, kurse nga pengjet e Hagës kanë frikë se po ua sfidojnë autoritetin, por jo edhe pushtetin. Uroj të gaboj, mirëpo mendja ma thotë se të tashmit do të pranojnë çdo gjë për të mbetur në pushtet duke pranuar çdo përmbytje, me ambalazhim tjetër. Sikur që i pranuan marrëveshjet deri më tani. Do ta bëjnë Manastirin e Deçanit pronar të 24 hektarëve të pronës me ligjet pirate të Sllobodan Millosheviqit. Arsyetimin e kanë te vendimi i Gjykatës Kushtetuese. Do ta pranojnë Zajebnicën duke ia ruajtur përmbytjen, me një veshje tjetër. Arsyetimi do të jetë se është marrëveshje ndërkombëtare, kurse këto marrëveshje janë mbi Kushtetutën e Kosovës. Dhe, arsyetimi kryesor do të jetë se do të liberalizohen vizat për Kosovën. Qartazi po shihet se Zajebnicën, Serbia dhe ndërkombëtarët, bashkë me babanë e autonomisë së Kosovës, ambasadorin Hill e kanë shndërruar në kërthizë pa të cilën nuk zgjidhet asgjë midis Kosovës dhe Serbisë duke e shndërruar në Nyje të Gordit. Albin Kurti e ka shpatën që do ta presë Nyjën e Gordit (Zajebnicën) ose, në të kundërtën, do ta presë kokën e tij politikë! Nuk jemi mirë, por kemi kaluar kohë edhe më të vështira!

Mehaj e Jashari shikojnë pajisje ushtarake në panairin 'AUSA 2022' në ShBA

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

Uashington, 11 tetor - Me ftesë të Asociacionit të Ushtrisë të Shteteve të Bashkuara (AUSA), ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, së bashku me komandantin e FSK-së, gjeneraljtënant Bashkim Jashari, po marrin pjesë në konferencën vjetore dhe Panairin e Industrisë së Mbrojtjes "AUSA 2022" në Uashington. Me këtë rast, përveç pjesëmarrjes në sesionet e konferencës dhe panairit vjetor,

ministri Mehaj dhe gjeneral Jashari u takuan me përfaqësuesit e kompanive më të njohura prodhuese të industrisë amerikane të mbrojtjes, respektivisht pajisjeve ushtarake si dhe, po ashtu, u njoftuan me zhvillimet më të fundit teknologjike në këtë fushë përmes prezantimeve informuese si dhe paneleve të diskutimit mbi fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Nga aktivitetet përkatëse, ministri Mehaj dhe gjeneral Jashari theksuan rëndësinë e madhe dhe mundësinë e shkëlqyer që ka kjo pjesëmarrje për ta vlerësuar faktin

që, krahas ndryshimit të kontekstit geopolitik, avancimit të teknologjisë ushtarake, avancimit të bashkëpunimit me shtetet aleate, të kemi në proporcion edhe investimet tona në zhvillimin dhe avancimin e aftësive dhe kapaciteteve operacionale të FSK-së. Me këtë rast ministri Mehaj theksoi se gjatë vitit 2021 kanë investuar në këtë drejtim 96 për qind më shumë sesa në vitin 2019, ndërsa deri në fund të këtij viti pritet që investimi të jetë 99 për qind më i lartë. Synimi ynë është që Ushtria e Republikës së Kosovës të jetë e

pajisur me armatimet më moderne ushtarake, e gatshme për t'i përballuar të gjitha sfidat e sigurisë.

Përveç takimeve gjatë panairit me përfaqësues të kompanive të industrisë amerikane të mbrojtjes, ministri Mehaj dhe gjeneral Jashari do të kenë takime në Departamentin e Mbrojtjes dhe atë të Shtetit, me zv/sekretarin Amerikan të Mbrojtjes, dr. Colin Kahl, drejtorin e Agjencisë së Bashkëpunimit për Sigurinë e Mbrojtjes (DSCA), James Hursch dhe shefin e Byrosë së Gardës

Kombëtare, gjeneral Daniel R. Hokanson.

Gjithashtu, gjatë vizitës katërditore pritet të takohen edhe me personalitete të tjera të larta politike e ushtarake si dhe përfaqësues të komunitetit shqiptaro-amerikan.

Vizita përkatëse e ministrit Mehaj dhe gjeneral Jasharit është shumë e rëndësishme në procesin e zhvillimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe shpreh fuqishëm partneritetin tonë shumë të ngushtë me ShBA-në në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Syla pret në takim zyrtarë të NATO-s, flasin për tranzicionin e FSK-së



PRISHTINË, 11 TETOR - Zëvendësministri i Mbrojtjes, Shemsi Syla, i shoqëruar nga Inspektori i Përgjithshëm i FSK-së, gjeneralmajor Irfete Spahiu, ka prituri në takim të emëruarën e re në pozitën e zëvendësasistentes për operacione e sekretarit të përgjithshëm të NATO-s, Burcu San, të shoqëruar nga drejtori i NALT-it, gjeneralbrigade Joachim Hoppe dhe Blanca Hereza-Atienza, oficerë e sektorit të operacioneve aktuale në selinë e NATO-s.

Në këtë takim u bisedua lidhur me situatën e përgjithshme në vend, rajon dhe më gjerë, planin gjithëpërfshirës të tranzicionit të FSK-së, bashkëpunimin ndërkombëtar, integrimin e komuniteteve pakicë dhe rritjen e numrit të grave dhe vajzave në FSK.

Me këtë rast, zëvendësministri Syla bëri me dije angazhimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe pozicionin e Republikës së Kosovës në kuadër të sfidave, kërcënimeve dhe rreziqeve në mjedisin aktual të

sigurisë dhe realitetit geopolitik aktual, veçanërisht pas agresionit rus në Ukrainë.

Zëvendësministri Syla ka theksuar veçanërisht procesin e integritetit në NATO të Republikës së Kosovës, si dhe me këtë rast njoftoi për objektivat strategjike të Ministrisë së Mbrojtjes në zhvillimin dhe avancimin e FSK-së, synimet në fushën e diplomacisë së mbrojtjes, bashkëpunimit ndërkombëtar si dhe angazhimin e Republikës së Kosovës dhe qeverisë së saj në proceset integruuese euroatlantike.

Ministri Krasniqi, pjesë e takimit regional evropian të Partneritetit për Qeverisje të Hapur

PRISHTINË, 11 TETOR - Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, me ftesë të Partneritetit për Qeverisje të Hapur - OGP, po qëndron në një vizitë zyrtare në Itali, ku po zhvillohet takimi regional evropian i OGP-së. Gjatë këtyre sesioneve, ministri Krasniqi do të real-

izojë takime me personalitete të larta shtetërore, anëtarë të shoqërisë civile dhe bizneseve për të diskutuar lidhur me mundësitë e bashkëpunimit në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, agjendën e gjelbër dhe përkrahjen për Republikën e Kosovës në procese të rëndësishme siç është edhe

anëtarësimi në OGP. MAPL ka përfunduar planin nacional të veprimit dhe angazhimin për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Partneritetin për Qeverisje të Hapur - OGP është prioritet duke u bazuar në rëndësinë e qeverisjes së hapur, llogaridhënëse dhe transparente.



Sekuestrohen rreth 100 objekte në pronësi të politikanëve e biznesmenëve në Brezovicë

Në total janë sekuestruar rreth 100 objekte në pronësi të politikanëve, biznesmenëve e qytetarëve, përfshirë 80 objekte të ndërtuara plotësisht e disa në ndërtim e sipër, ka bërë me dije Prokuroria Themelore e Ferizajt

PRISHTINË, 11 TETOR - Objekte në pronësi të politikanëve, biznesmenëve e qytetarëve janë sekuestruar më 11 tetor në Brezovicë, tha për "Radion Evropa e Lirë", prokurori i Prokurorisë Themelore të Ferizajt, Rasim Maloku. Sekuestrimi i rreth 100 objekteve u bë me urdhër të Prokurorisë së Shtetit, pas vlerësimit të raporteve nga Drejtoria për Hetimin e Krimeve të Rënda në Prishtinë, Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.

Këto institucione, pas inspektimit të objekteve të ndërtuara në Brezovicë, kanë vlerësuar se këto objekte janë ndërtuar në kundërshtim me Ligjin për Parkun Kombëtar "Sharri" dhe planin hapësinor për këtë park. Sipas prokurorisë, objektet janë ndërtuar duke keqpërdorur detyrën zyrtare nga të pandehurit në këtë rast, me lëshimin e lejeve ndërtimore në kundërshtim me ligjet që rregullojnë Parkun Kombëtar "Sharri", me marrje të ryshfetit, dhënie të ryshfetit, kanë

degraduar mjedisin në këtë zonë, kështu që edhe objektet janë rrjedhojë e këtyre veprave penale.

Prokurori Maloku tha se të gjitha objektet e ndërtuara në zonën e dytë të Brezovicës janë sekuestruar përkohësisht. Sipas Malokut, i cili është edhe prokuror i rastit "Brezovica", në këtë zonë nuk lejohet ndërtimi. "Këto janë, kryesisht, vikend-shtëpiza apo vila. Ka qenë edhe një hotel. Edhe atë e kemi sekuestruar. Ndërkaq objektet hoteliere gjenden në zonën e tretë [të Parkut Kombëtar "Sharri"] dhe në ditët në vijim do të shikojmë se çfarë do të bëjmë me to", tha Maloku. Në mesin e objekteve të sekuestruara janë 80 objekte të ndërtuara plotësisht e disa në

ndërtim e sipër. Ai bëri me dije se nuk mund t'i publikojnë emrat e pronarëve të objekteve të sekuestruara, por tha se pasi ata të lajmërohen tek autoritetet për të deklaruar se janë pronarë, prokuroria më pas do t'i bëjë publike emrat. Rasti gjyqësor Brezovica është iniciuar në dhjetor të vitit 2021. Deri më tani janë arrestuar dhjetëra persona, përfshirë edhe ish-kryetarin e komunës së Shtërpçës, Bratislav Nikolliq, por edhe zyrtarë të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Nikolliq, që është zyrtar i lartë i partisë kryesore të serbëve në Kosovë, Lista Serbe, dyshohet për keqpërdorim të pozitës zyrtare.

Maloku tha se lejet e ndërtimit janë lëshuar gjatë kohës sa Nikolliq ka qenë në pushtet. "Lejet i ka dhënë komuna e Shtërpçës, Drejtoria e Urbanizimit, kryesisht kryetari, tashmë ish-kryetari, sepse pa të asnjë letër nuk është lëshuar", tha ai.

Prokurori Maloku tha se hetimet për rastin "Brezovica" po vazhdojnë, duke shtuar se edhe gjatë vitit të ardhshëm do të dërgohen lëndë në gjykata për disa të dyshuar. Brezovica vlerësohet se është një prej qendrave më të mëdha të turizmit dimëror në Kosovë dhe njihet për qendrën e saj të skijimit. Ajo gjendet në komunën e Shtërpçës dhe bën pjesë në Parkun Kombëtar "Sharri".



Banka Botërore: Ngadalësohet rritja ekonomike e Kosovës në 3.1 për qind

PRISHTINË, 11 TETOR - Pas një ngadalësimi të investimeve dhe konsumit privat, rritja reale e Prodhimit të Brendshëm Bruto të Kosovës për vitin 2022 pritet të ngadalësohet në 3.1 për qind.

Sipas raportit "Mbrojtja Sociale për Rimëkëmbje", në kontekstin aktual, mbështetja për ta zbutur ndikimin e çmimeve në rritje të energjisë dhe ushqimeve duhet të fokusohet te më të cenueshmit. "Në periudhën afatmesme, zbatimi i përsheptuar i reformave strukturore në energji, arsim, mbrojtje sociale dhe kujdes shëndetësor është thelbësor për ta rritur rritjen ekonomike gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme të



Kosovës", thekson raporti. Po ashtu, guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka thënë se ka ngadalësim të rritjes ekonomike në vitin 2022. Në Komisioni për Buxhet dhe Financa, Mehmeti pati thënë se parashikimet gjatë këtij viti

janë rreth 3 për qind. Kjo, sipas tij, po ndodh për shkak të dobësisht të fuqisë blerëse, zvogëlimit të kërkesës së brendshme dhe rritjes së deficitit të eksportit neto. "Rritja e lartë e aktivitetit ekonomik e realizuar në vitin 2021 pritet të ngadalësohet në

vitin 2022 dhe parashikimet tona janë që të jetë diku rreth 3 për qind. Ngadalësimi i rritjes ekonomike pritet të jetë kryesisht pasojë e rritjes më të ulët të kërkesës së brendshme dhe rritjes së deficitit të eksportit neto. Përderisa reziqet nga pandemia janë zvogëluar, rritja e rimëkëmbjes ekonomike pritet të ngadalësohet nga pasojat e tashme të dy krizave, e para është pengesat ende evidente nga zinxhiri i furnizimit nga pandemia dhe presioni shoqëruar të inflacionit të kombinuar me efektet e kombinuar të luftës në Ukrainë që e përforcoi edhe më tej rritjen e çmimeve, dobësimin e fuqisë blerëse dhe

rënien e besueshmërisë", pati theksuar Mehmeti.

Ai ka thënë se inflacioni në Kosovë është i importuar dhe çdo masë e tij vetëm do ta pengonte rritjen ekonomike. "Çdo masë e marrë në këtë drejtim neve na çon vetëm në stagflacion, pra ka shumë efekte dhe pengon rritjen e aktiviteteve ekonomike në vend. Përderisa inflacionin e kemi të importuar nga jashtë, faktikisht, me rritjen e përqindjes së rezervës të detyrueshme, ne shumë pak do të mund të bënim në këtë drejtim dhe, në anën tjetër, dëmi do të ishte i madh sa i përket pengesës që do të kishte në rritjen ekonomike në vend", kishte thënë Mehmeti.

Viti 1914 dhe një vullkan me emrin Evropë

Në fillimet e nëntëqindës mbizotëronte besimi në të ardhmen, por tensionet e nëndheshëm prodhuan katastrofën



Europa e vitit 1914 u shndërrua shumë shpejt në legendë, pasi më shumë se katër vite luftë kishin tronditur çdo aspekt të jetës së saj civile dhe morale. Po çfarë ishte ajo botë e luftës së parë, që më vonë u bë objekt i shumë rikthimesh nostalgjikë?

Realiteti i dimensioneve të saj materiale dhe morale ishte imponues. Pak vende europiane kishin në zotërim tre të katërtat e globit. Ushtritë dhe flotat e tyre ishin të frikshme dhe të fuqishme. Ekonomitë e vendeve më të zhvilluar ishin të tilla që nuk mund të kishin me kë të krahasoheshin, përveç se me SHBA. Londra dhe Parisi ishin kryeqytetet e financës botërore. Cilësia e jetës ishte superiore ndaj kontinenteve të tjerë. Kudo, ndonëse me ngadalësi, po afirmohej një regjim lirire.

Edhe më shumë mund të thuhet për kulturën, progresin shkencor dhe teknik, qendrat studimore. Atmosfera e përgjithshme ishte e frymëzuar nga një optimizëm i pakufishëm: ndoshta vetëm në kohën e Iluminizmit, në Shtatëqindën, fatet e njerëzimit ishin dukur po kaq “të mrekullueshëm dhe progresistë”. Kishte nga ata që, ashtu sikurse natyralisti i madh Ernst Haeckel (me romanin e shitur në 400 mijë kopje), mendonin se nga “shtatë

enigmat e mëdha të botës” gjashtë ishin zgjidhur tashmë, kështu që mbetej vetëm njëra për t’u zgjidhur. Edhe lufta konsiderohej një mundësi e padyshimtë e historisë, por gjithësesi kishte lindur ndërkohë një lëvizje pacifiste me shtirje shumë të gjerë (një prej çmimeve të parë Nobel u dha që në fillim për Paqen, dhe në vitin 1907 iu dha italianit Ernesto Moneta).

Për të gjithë këto arsye, u fol për një Belle époque, përpara tragedisë së luftës. E megjithatë, në këtë botë sigurish dhe optimizmas, shumë shtytje dhe ngacmime eksplicitë dhe implicitë shfaqeshin të ndryshëm apo në kundërvënje mes tyre. Duke filluar që nga vetë pozicioni i Europës në botë. SHBA dhe Japonia ishin tashmë fuqi ekonomike, politike dhe ushtarake të nivelit të lartë. Në zotërimet europiane kishin filluar lëvizjet politike dhe sociale për pavarësinë, që Europa i përballonte me vështirësi, pasi këto zhvilloheshin mbi ide tërësisht europiane.

Megjithatë, më të rëndë ishin problemet e brendshëm, si ai nacional dhe ai social. Megjithëse aspiratat nacionale ishin kënaqur tashmë në shumë vende, të shumtë ishin popujt për të cilët kjo nuk kishte ndodhur. Ndodhte kështu në Irlandë, mes çekëve dhe italianëve të Austro-Hungarisë, mes polakëve

të Austrisë, Gjermanisë e mbi të gjitha Rusisë. Në ndonjë rast bëhej fjalë edhe për hakmarrje të hapura, si për shembull mes Francës dhe Gjermanisë për luftën e 1870-71, që kushtoi humbjen e Alsasës dhe Lorenës. Po kështu, kombet e Ballkanit ishin në një rrëmujë të paqeverisëshme. Mes viteve 1911 dhe 1913 kishin luftuar në luftëra të ndërlikuara me Turqinë dhe të gjithë ndiheshin të keqtrajtuar nga marrëveshjet e mëvonshme të paqes. Prandaj nuk ishte rastësi që pikërisht në Ballkan ndodhi atentati që shkaktoi luftën e madhe.

Vetëdija e këtyre tensioneve themelore nxiste një garë konstante për armatim në të gjithë fuqitë e mëdha dhe të vogla, si për shembull mes Gjermanisë dhe Anglisë në dete. Të forta ishin edhe rivalitetet për kolonitë. Vetëm në fund u shmangën konflikte mes Francës dhe Anglisë në 1898 dhe mes Gjermanisë dhe Francës në 1907. Por militarizmi dhe luftëdashja ishin më të fortë se sa pacifizmi, dhe mund të mbështeteshin në krenaritë dhe interesat kombëtarë me rënë të thella. Kundër rrezikut të luftërave në kushte disavantazhi, dhe për shkak të shqetësimeve të ekuilibrit dhe maturisë politike, kishin lindur dy sisteme aleancash: treshja Gjermani, Itali dhe Austro-Hungari dhe dyshja Francë-Rusi.

Në momentin e të vërtetës u pa që ishin zinxhirë kushtëzues që e bënin luftën edhe më të pashmangshme, dhe të tillë që të tërhiqnin në konflikt edhe Anglinë, e vetmja fuqi e madhe europiane që nuk ishte pjesë e asnjë aleance.

Për çështjen sociale, problemet ishin dhe më të mëdhenj. Revolucioni industrial ishte në kulmin e tij në shumë vende, apo vetëm në fillime në disa të tjerë, por të gjithë i vuanin pasojat globale. Po lindte ndërkohë një emigracion i madh sidomos drejt Amerikave. Punëtorë dhe fshatarë ishin në lëvizje të vazhdueshme. Edhe për shkak të ndikimit të ideologjive marksiste, ata ushqenin pakënaqësi dhe dëshira për përmbyseje që e bënin luftën e klasave një element të fortë të panoramës sociale, që justifikohej prej kushteve të jetesës së masave, pavarësisht përparimeve të bërë mbi të gjitha tek vendet e përparuar. Vetëm në këta vende kishin lindur më pas forma të largpamësisë sociale, ndërkohë që greva dhe sindikatat shumë ngadalë po shndërroheshin në një të drejtë. Kështu që, nga një anë ekzistonte frika e “trufesë” së një revolucioni të madh social, nga ana tjetër binte hija e një reagimi të madh politiko-social.

Në kulturën europiane të gjithë këto

pasqyroheshin në sjelljet, shqetësimet, grindjet, gjëra krejt të kundërta me kushtet në dukje të lumtura të kësaj zone të botës. Flitej për luftëra të mundshme, por në Europë prej një shekulli nuk kishte patur më konflikte që të përfshinin të gjithë shtetet. Dhe pikërisht ky mbizotërim i përgjithshëm i paqes, ky rend, kjo qetësi, kjo gjendje e një “shëndeti të mirë” nxiste reagime të kundërt. Futurizmi italian ishte një dokument mbresëlënës. Gjithçka që ishte “normale” shfaqej e dhimbshme, një mediokritet “borgjez” i padurueshëm. Rroftë shpejtësia e marrë, rroftë lufta, rroftë gjithçka që të prishte disiplinat dhe kriteret e traditave shtypëse, rroftë impulsat e vullnetit për pushtet dhe kënaqësi.

Paralajmërohej, më shumë nga sa dukej, se një e keqe e fshehtë, një vullkan i fshehur kërcënonte atë botë që parapëlqente të ekspozonte fatet e saj të mrekullueshëm. Në fakt, disa prej intelektualëve të mëdhenj europianë e paralajmëruan. Por ndoshta të gjithë këto paralajmërimi mund t’i gjejmë në melankolinë e thellë që jehon në galopin e valles se Excelsior-it apo në valset e Straussit: melankolia për diçka të bukur dhe të ëmbël që po rrëshket dhe po merr fund. / *Corriere della sera* – *bota.al*

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Barcelona synon fitore ndaj Interit për t'i ruajtur shpresat për kualifikim

"Epoka e re"

BARCELONË, 11 TETOR - Barcelona do të kërkojë fitore në përballjen me Interin sonte (e mërkurë) dhe në këtë mënyrë t'i ofrohet kualifikimit në fazën tjetër. Ekipi katalanas është i treti në Grupin C, tri pikë prapa Interit të vendit të dytë, me gjigantët italianë që shënuan një fitore 1-0 në ndeshjen e javës së kaluar që u zhvillua në "San Siro". Barcelona nuk arriti ta kalojë fazën e grupeve në Ligën e Kampioneve sezonin e kaluar dhe rrezikohet edhe këtë edicion, pasi nga tri ndeshje ka grumbulluar vetëm tri pikë, por nëse e mposhtë Interin, shanset do të rriten më shumë. Skuadra e drejtuar nga Xavi Hernandez e hapi fushatën në fazën e grupeve me një fitore 5-1 ndaj Viktorias Plzenit më 7 shtator, por ka humbur nga Bayerni (2-0) dhe Interi (1-0). Barcelona fitoi ndeshjen e fundit në La Liga ndaj Celta Vigos me golin e vetëm të shënuar nga Pedri dhe kjo fitore i ndihmoi të jetë lider në La Liga, me pikë të

barabarta me Realin. Barça do të përpigjet që këtë ndeshje ta fitojë në mënyrë që të motivohet para "El Clasico"-s që zhvillohet në fundjavë. Në anën tjetër, Interi ka gjashtë pikë, pasi mposhti Viktoria Plzenin dhe Barcelonën dhe në ndeshjen tjetër pësoi nga Bayern

Muncheni. Interi në këtë ndeshje vjen pas fitores në fundjavë ndaj Sassuolos (2-1). Frenkie de Jong është rikthyer nga lëndimi kundër Celtas në fundjavë, por Franck Kessie, Andreas Christensen, Hector Bellerin, Ronald Araujo, Memphis Depay

GRUPI A			GRUPI C		
18:45 Napoli - Ajax 21:00 Rangers - Liverpool			21:00 Barcelona - Inter 21:00 Viktoria Plzen - Bayern Munchen		
Tabela			Tabela		
Pikë	Napoli	3	Pikë	1. Bayern Munchen	3
	2. Liverpool	3		2. Inter	3
	3. Ajax	3		3. Barcelona	3
	4. Rangers	3		4. Viktoria Plzen	3
		0			
GRUPI B			GRUPI D		
18:45 Atletico Madrid - Club Brugge 21:00 Bayer Leverkusen - Porto			21:00 Sporting CP - Marseille 21:00 Tottenham Hotspur - Eintracht Frankfurt		
Tabela			Tabela		
Pikë	1. Club Brugge	3	Pikë	1. Sporting CP	3
	2. Porto	3		2. Tottenham Hotspur	3
	3. Bayer Leverkusen	3		3. Eintracht Frankfurt	3
	4. Atletico Madrid	3		4. Marseille	3



FORMACIONET E MUNDSHME:

Barcelona: Ter Stegen; Roberto, Pique, E Garcia, Alonso; Gavi, Busquets, Pedri; Dembele, Lewandowski, Fati.
Inter: Onana; Skriniar, De Vrij, Bastoni; Dumfries, Barella, Calhanoglu, Mkhitaryan, Dimarco; L Martinez, Dzeko.

dhe Jules Kounde mbesin jashtë fushës. Interi do t'i ketë këto mungesa Dalbert, Marcelo Brozović, Alex Cordaz, Joaquin Correa, Gabriel Brazao dhe Romelu Lukaku mbeten jashtë

fushës për gjigantët italianë. Në këtë grup nga ora 21:00 përballen Viktoria Plzeni dhe Bayern Muncheni. Favorit llogariten gjermanët që i kanë fituar tri ndeshjet e para të grupit.

Kampionët e Kosovës sonte e kanë sfidën e parë në FIBA Europe Cup

Suharekë, 11 tetor - Golden Eagle Ylli sot (e mërkurë) do ta ketë ndeshjen e parë në grupet e FIBA Europe Cup. Kjo është paraqitja e parë për therandasit në këtë garë. Kampionët e Kosovës do të përballen me skuadrën izraelite Hapoel Nofar Galil Elion. Sfidat zhvillohet nga ora 19:00 në palestrën "Sezai Surroi" në Prizren, ndërsa do të transmetohet në platformat Art Motion & Kujtesa. Në këtë grup janë edhe dy skuadrat gjermane Brose Bamberg dhe Niners Chemnitz. Ylli garon në FIBA Europe Cup, pasi në kualifikimet e Ligës së Kampioneve ishte mundur nga Benfica e Portugalisë. Derisa kjo është paraqitja e parë për kampionët



e Kosovës në këtë garë, shpresojnë në paraqitje të mira, edhe pse do ta kenë shumë vështirë.

Sadiku është gati për Kampionatin Evropian të Boksit

Prishtinë, 11 tetor - Medalistja botërore në boks në kategorinë e 60 kilogramëve, Donjeta Sadiku, së bashku me selektorin Faton Xhakli dhe trajneren Marjola Sallauka, më 12 tetor udhëtojnë në Kampionatin Evropian për Seniore që mbahet në Budva (Mali i Zi). Ky eveniment do të mbahet nga data 14 deri më 23 tetor, ndërsa boksierja jonë shpreson ta fitojë medaljen e artë. Sipas trajneres Marjola Sallauka, Donjeta është në formë të mirë dhe e përgatitur maksimalisht për këtë kampionat evropian. Ajo shpreson dhe beson se nga ky kampionat evropian Sadiku do të kthehet me medalje të artë. Duhet cekur se boksierja ka qenë kampione evropiane juniore dhe



nënkampione e Evropës për të Reja (Youth). Edhe këtë vit pritet që Donjeta të kurorëzohet me titullin e kampiones së Evropës dhe me medaljen e artë edhe si seniore.

Superkupa Mbarëkombëtare e Femrave mbahet në Prizren

Prizren, 11 tetor - Liga Unike ka njoftuar se Superkupa Mbarëkombëtare në konkurrencën e femrave do të mbahet në Prizren në bashkëpunim me KBF

Bashkimin. Në këtë garë do të marrin pjesë kampionet dhe fituesit e Kupave të Kosovës dhe Shqipërisë. Turneu do të organizohet më 26-27 tetor në "Sezai

Surroi" të Prizrenit, ndërsa do të marrin pjesë Bashkimi i Prizrenit, Penza e Pejës, Flamurtari i Vlorës dhe Partizani i Tiranës. Në sfidën e parë do të përballen

Flamurtari - Partizani, kurse në atë të dytë Penza - Bashkimi. Në edicionin e kaluar kishte triumfuar Penza, turne që ishte zhvilluar në Vlorë.



Sonte zhvillohet ndeshja e mbetur Trepça - Prishtina

PRISHTINË, 11 TETOR - Sot (e mërkurë) do të zhvillohet ndeshja e mbetur e xhiros së tretë të Prince Caffè Superligës ndërmjet

Trepçës dhe Sigal Prishtinës. Sfidat zhvillohet nga ora 19:00 në "Minatori" të Mitrovicës ku, si zakonisht, pritet një

atmosferë e bukur sportive. Ky takim ishte shtyrë për shkak të pjesëmarrjes në garat evropiane të këtyre dy skuadrave. Këto dy skuadra

renditen në pozitë tre dhe katër, me tri fitore e një humbje, andaj pritet një përballje shumë interesante mes këtyre dy skuadrave.



Khudoja e Kosovës përfundon garat në Kampionatin Botëror

PRISHTINË, 11 TETOR - Khudistët e Kosovës i kanë përfunduar garat në Kampionatin Botëror të Xhudos që po mbahet në Uzbekistan. Distria Krasniqi fitoi medaljen e bronzit në kategorinë 52 kilogramë, kurse Loriana Kuka u ndal në luftën e dytë.

I lumtur me paraqitjet e khudistëve është në këtë kampionat është shprehur trajneri Driton Kuka, edhe pse ka thënë se mund të bëhej edhe më mirë. Për Loriana Kukën trajneri ka thënë se ende nuk është në formën e saj më të mirë për shkak të lëndimit. "Loriana shënoi një fitore dhe mandej pësoi humbje dhe realisht forma e saj ka ngritje, por ende është në 70 % të formës për shkak të lëndimit në fillim të vitit, por shpejt besoj do të vij në nivelin e saj, normalisht, me përkushtim në stërvitje e me qëllim e dedikim më të madh drejt Olimpiadës", ka shkruar Kuka në "Facebook". Më pas Kuka ka folur edhe për Laura Fazliun dhe paraqitjet e khudistëve të tjerë. "Laura Fazliu 63 kg sivjet arriti titullin e nënkampiones evropiane dhe prej asaj gare si duket vetëkënaqësia e medaljes nuk po e lë të koncentrohet në gara të tjera. Ana e saj taktike



shumë e padefinuar dhe pothuajse shumë pak punon në këtë drejtim. Kjo tregon që duhet ndërruar qasjen urgjent. Humbi me një diskualifikim të çuditshëm, por me garues të atij niveli nuk duhet lejuar të ndodhin aksione me rrezik: "Flaka Loxha 57

kg përformoi jo mirë dhe realisht niveli i saj për një botëror ende nuk ka arritur ku duhet. Anën fizike e ka të mirë, por i mungojnë gjuajtjet në këtë nivel. Problem që e potencojmë çdo stërvitje në sparing në klub, por ende nuk ka ecje para", ka shkruar Kuka.

Sokoli: Nuk më ka kontaktuar askush nga Ferizaj

FERIZAJ, 11 TETOR - Klubi i Futbollit Ferizaj ka mbetur pa trajner pas dorëheqjes së Arbnor Morinës nga kjo pozitë. Së bashku me Morinën nga kjo skuadër është larguar edhe një pjesë e stafit teknik dhe kjo ka ngjallur pasiguri te tifozët e kësaj skuadre. Bylbyl Sokoli është emri i përmendur si potencial për ta marrë drejtimin e Ferizajt, por ai i ka mohuar këta zëra. Sokoli ka thënë për "KosovaPress" se ende nuk ka marrë asnjë ofertë zyrtare nga Ferizaj. "Deri në këtë moment zyrtarisht askush nuk më ka kontaktuar", ka thënë Sokoli. "Në Ferizaj kam shumë miq, e njoh mjedisin. Sa kam pasur mundësi të kuptoj, klubi është i organizuar shumë mirë. Për angazhim, varet prej projektit", ka thënë Sokoli. Ndryshe, të martën, presidenti i



klubit, Lulzim Abazi, iu drejtua me një letër tifozëve duke thënë se ata nuk duhet të ndihen të pasigurt pasi që klubi është duke punuar fuqishëm për ta gjetur një

trajner me përvojë dhe njerëz të dëshmuar në futboll. Ferizaj pozicionohet në vendin e fundit të renditjes tabelore me vetëm tetë pikë pas dhjetë ndeshjeve.

SHKURT

Muriqi, pas kartonit të kuq: Do të luftoj deri në maksimum për Mallorcan

Vedat Muriqi ka reaguar pas kartonit të kuq që mori në ndeshjen ndaj Elches (1-1). Sulmuesi prizrenas u kërkoi falje tifozëve për shkak që e mori kartonin e kuq. "Edhe dje kam dhënë gjithçka nga vetja. Do të doja të kontribuoj shumë më tepër për ekipin tim. Dua t'ju kërktoj falje të gjithë. Nuk do të ndalem duke luftuar deri në pikën e fundit të gjakut për këtë skuadër", ka shkruar Muriqi në "Twitter". Kujtojmë se Muriqi shënoi një gol nga pika e bardhë në pjesën e dytë, por edhe e humbi një 11 metërsh paraprakisht në pjesën e parë.

O'Neal: Dua të jem pronar i një skuadre në NBA

Ish-basketbollisti amerikan Shaquille O'Neal, tashmë 50-vjeçar, në një intervistë për CNN, ka konfirmuar dëshirën e tij për të qenë pronar i një prej 30 skuadrave në NBA. Në karrierën e tij "gjiganti" i parketit ka fituar katër tituj kampionë. "Nuk e di nëse jam i autorizuar ta them, pasi ndoshta është mungesë respekti. Dua të rikthehem në shtëpi, të kem një skuadër timen. Ua lë spektatorëve të kuptojnë se çfarë do të thotë kjo zgjedhje imja", ka thënë O'Neal, katër tituj kampionë në NBA. Javën e fundit Shaquille ka qenë në Abu Dhabi, si i ftuar special në dy ndeshjet miqësore që skuadrat e Milwaukee Bucksit dhe Atlanta Hawksit zhvilluan aty, për ta promovuar basketbollin amerikan. Aty ai konfirmoi dëshirën e tij për t'i blerë kuotat e një skuadre të NBA-së. E paqartë fjala "shtëpi", nëse O'Neal dëshiron të ketë një ekip në San Antonio, ku ka luajtur në Lice, apo në New Orleans, ku ka bërë universitetin. Ndërkohë që ai ka luajtur edhe me Orlandon, Miamin, Phoenixin, Lakersin, Clevelandin e Bostonin.

Klauzola pro-Realit ekziston për Haalandin

Klauzola pro transferimit të Real Madridi vijon të jetë temë e medieve evropiane për Erling Haaland. Manchester City mohoi ekzistencën e saj, por "The Athletic" këmbëngul se është e vërtetë, madje jep dhe shifrën për të cilën mund të realizohet: 200 milionë euro. Një klauzolë që vlen për transferimin jashtë vendit për Haalandin dhe jo për klube të tjera në Premierë Ligë. Lëvizja mund të realizohet në vitin 2024, ndërkohë kujtojmë se edhe për Mbappen përflitet se Real ka një marrëveshje verbale për një transferim në vitin 2024. Haaland ka thyer çdo rekord në fushën e lojës, duke u bërë i riu që arrin më shpejt 25 gola në Ligën e Kampionëve. Real ndërkohë e sheh me admirim nga larg, duke pritur vitin 2024, ku dhe mund të ndodhë një nga lëvizjet më të bujshme vitet e fundit.

'Marca': Mbappe dëshiron të largohet në janar nga PSG-ja

Marrëdhënia mes Kylian Mbappes dhe PSG-së është "shkatërruar". Kështu shkruan "Marca", duke cituar burime pranë lojtarit. Sulmuesi madje thuhet se është përpjekur të largohet gjatë verës, por nuk e gjeti rrugën e arratisjes dhe tashmë e kërkon në janar. Mbappe ndihet i tradhtuar nga një klub që nuk do t'i kishte përmbushur premtimet e bëra në momentin e rinovimit. Nga ana e tij, klubi parisian e ka bërë të qartë se lojtari nuk do të shitet te Real Madridi, por thuhet se Liverpools po studion situatën e futbollistit francez.

De Rossi emërohet trajner i Spalit

Daniele De Rossi është trajneri më i ri i Spalit. Karriera e trajnerit kampion bote në vitin 2006 fillon me Spalin në kampionatin e Serisë B, që e sheh Spalin në

vendin e 14-t në renditje me 9 pikë në 8 ndeshje të luajtura. Kujtojmë se De Rossi, për t'u lidhur me këtë projekt, largohet nga roli i ndihmësit të trajnerit të

Italisë, Roberto Mançini. "Spal njofton se i ka besuar Daniele De Rossit postin e trajnerit të ekipit të parë. Trajneri i ri Biancazzurro ka nënshkruar kontratë deri

më 30 qershor 2024. Nga sot Daniele De Rossi është trajneri i ri i Spal", thuhet në njoftimin e Spalit. Pas përfundimit të karrierës si futbollist, De Rossi i

bashkohet stafit të trajnerit të kombëtares Roberto Mançini, së bashku me të cilin më 11 korrik 2021 në "Wembley" ngre trofeun e kampionit të Evropës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 1468/1
Dt: 11.10.2022

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2021, Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

Ri-SHPALLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendeve të lira në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj për vitin shkollor 2022/2023

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Ferizaj	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën Matematikë, 14 orë mësimore;	Vend i lirë
			Një (1) mësimdhënës/e për lëndët Gjuhë Gjermane 18 orë mësimore;	Zëvendësim
			Një (1) mësimdhënës/e për lëndët As. Siguria Ushqimore dhe Dieta 20 orë mësimore;	Zëvendësim

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillt me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/a jo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrë të duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës së punës në arsim, nëse ka;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysnë, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Procedurat e konkurrimit:**
- Afati i konkurrimit është 7 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
- Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgatitjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregatitje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Agnesa Shala shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme "Xhevdet Doda" Prishtinë.

Agon Aliu shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme "Gjin Gazulli" Prishtinë.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira për 1 qershor deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



Adr: Rr. "Zija Shemsiu", nr.22, Ulpianë - Prishtinë
Tel: +383 (0) 38 606 670; +383 (0) 38 606 672; 0800 11 672
e-mail: mirembajtja@npbanesore.com; info@npbanesore.com

Në bazë të dispozitave të Nenit 8 të Ligjit të Punës, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, Neni 4, Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A në Prishtinë, shpall:

K O N K U R S

Për plotësimin e vendit të punës

Titulli: Kryepunëtor/e i/e Terenit-Asfaltues - 1 (një) pozitë

Nr. i referencës: NPB/DIU/ 9.6

I raporton: Udhëheqësit të Divizionit të Intervenimeve Rrugore

Niveli i pagës: 6

Orët e Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e kontratës: Me kohë të pacaktuar (puna provuese deri në 3 muaj)

Vendi i punës: Rr."Zija Shemsiu" nr.22, Ulpianë- Prishtinë (selia e Ndërmarrjes Publike Banesore)

Detyrat e përgjithshme:

- Është përgjegjës për realizimin e objektivave të caktuara nga Udhëheqësi i Divizionit që kanë të bëjnë me Divizionin për Intervenime Rrugore (me tutje DIRR);
- Ndihmon Udhëheqësin e Divizionit bashkë me Kryepunëtorët e tjerë në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave për Departamentin e Intervenimeve Urgjente;
- Koordinon punët në mes grupeve së bashku me kryepunëtorët e tjerë në lidhje me kërkesat dhe nevojat për kryerjen e aktiviteteve të nevojshme që kanë të bëjnë me DIU-në;
- Merr pjesë në mbledhjet e rregullta bashkë me kryepunëtorët e grupeve tjera e cila është në kuader të divizionit;

Detyrat specifike:

- Kryen punët e Departamentit të Intervenimeve Urgjente në operimin e aktiviteteve të mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore që kërkohen nga udhëheqësi i Divizionit;
- Kryen punët e Departamentit të Intervenimeve Urgjente në operimin e aktiviteteve të ndërtimit të ulët dhe enterierit dhe aktiviteteve operative që kërkohen nga Udhëheqësi i njësisë për investime si dhe Udhëheqësi i Divizionit;
- Është përgjegjës për të gjitha punët të cilat i kryen grupi;
- Është përgjegjës për mbarëvajtjen e të gjithë procesit të punës së grupit;
- Bën: përgatitjen e llaçit, muratimi i mureve me materiale dhe dimensione të ndryshme, muratimi i mureve ndarëse, punimi i themeleve, punimi i armaturës, betonimi, kryerja e punimeve suvatuese, ndërtimi i kulmeve, punimi i dyshemeve me produkte të betonit, mbulimi i kulmeve, shtruarja dhe veshja me pllaka, kryerja e punimeve izoluese;
- Mban përgjegjësi për materialin e shpenzuar si dhe shpenzimet e materialit i shënon në dëshmitë përkatëse sipas dokumentacionit të NPB për punët të cilat i kryen;
- Të jetë i gatshëm të punojë në ambiente të hapura dhe të mbyllura;
- Të jetë i gatshëm të punojë në temperatura dhe mot të ndryshueshëm;
- Të jetë i gatshëm të punojë në turne të ndryshme, me orar të zgjatur kur nevojitet;
- Të jetë i gatshëm të punojë nën presionin që sjell puna në qytet, ku përfshihen: puna në rrugë me trafik të ngarkuar, puna në rrugë të ngarkuara me kalimtarë, puna me komunitetet dhe kategori të ndryshme shoqërore;
- Raporton për punët e kryera të udhëheqësi i Divizionit për Intervenime;
- Propozon emërimet në pozita adekuate për punonjësit e grupit në bazë të performancës tek udhëheqësi i divizionit;
- Është përgjegjës për performimin e stafit, bën vlerësimin e secilit të punësuar në grupin që Mbikëqyr në baza mujore, gjashtë mujore dhe vjetore;
- Siguron që niveli i punonjësve, pajisjet dhe sistemet janë adekuate për përmbushjen e funksioneve të DIU-së.
- Mbikëqyr punëtorët e grupit në përmbushjen e objektivave të bazuara në planin operacional dhe planin e punës;
- Propozon masa disiplinore ndaj punonjësve që kanë performancë të dobët në përmbushjen e detyrave të punës tek Udhëheqësi i Divizionit;
- Kontrollon punët dhe mban mbledhje me stafin përgjegjës për punët e kryera ose për pengesat në punë në grupin që Mbikëqyr;
- Përgatit raportet e punës në baza ditore, javore, mujore, vjetore për grupin.

Kualifikimet

- Diplomë e shkolles së mesme;
- Dëshmi për përvojë pune së paku 2 vite në organizimin e grupeve të ndërtimit;
- Patent shofer kategoria-B;

Aftësitë:

- Shkathësi për të punuar në grup, nën presion dhe të dëshmojë fleksibilitet në punë;
- Njohje të shkëlqyer të materialeve dhe mjeteve të punës që kanë të bëjnë me punë ndërtimore;
- Të ketë kujdes të shtuar dhe të respektojë normat për sigurinë në punë;
- Duhet të jetë në gjendje të lexojë, kuptojë manualët që kanë të bëjnë me makinat dhe procesin e ndërtimit;
- Të jetë i gatshëm të punojë në objekte me lartësi të madhe;
- Të jetë në gjendje të bëjë paramasat dhe parallogaritjet për investimet ndërtimore;
- Të jetë i gatshëm të punojë në të gjitha kushtet atmosferike;
- Të jetë i gatshëm të punojë natën dhe fundjavave;
- Të jetë i gatshëm të qëndrojë në këmbë për periudha të gjata kohore;
- Aftësi të punojë në ekip, të ketë vetëiniciativë dhe qasje konstruktive;

- Shkathësi të shkëlqyera komunikative, organizative dhe analitike;
- Etikë në punë dhe integritet të lartë;
- Shkathësi për të punuar në grup, nën presion dhe të dëshmojë fleksibilitet në punë;

Kualifikimet e preferueshme:

- Kurset dhe trajnimet tjetra gjatë karrierës profesionale.
- Patent shofer në kategoritë tjera relevante për mjete transportuese dhe mjete të rënda të punës.

Procedura e Konkurrimit

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyrat e Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes

Publike Banesore apo ta shkarkojnë nga web faqja e internetit në adresën: www.npbanesore.com/shpalljet/mundesit-punesimi/. Dokumentacionin mund ta paraqesin në kopje fizike në Divizionin e Burimeve Njerëzore në adresën: rr. Zija Shemsiu, nr. 22, Prishtinë, ose të aplikojnë përmes emailit zyrtar: burimet.njerezore@npbanesore.com apo përmes postës. Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen në procedura të tjera të rekrutimit.

Dokumentet që duhet të bashkangjiten:

- Aplikacioni i NPB-së;
- Dëshmitë për Shkollën e Mesme;
- Dëshmitë për përvojën e punës së paku 2 vite në organizimin e grupeve të ndërtimit;
- Certifikatën që nuk jeni nën hetime nga Gjykata (jo më e vjetër se gjashtë muajt);
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Patent shofer kategoria-B;
- Kopjen e letërnjoftimit;

Shënim: Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tri (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen. Kandidati/ja i/e përzgjedhur obligohet të sjellë certifikatën mjekësore para nënshkrimit të kontratës.

APLIKACIONET DHE DOKUMENTACIONI I PAKOMPLETUAR SIPAS KËRKESAVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË SHPALLJE SI DHE ATO QË ARRIJNË PAS SKADIMIT TË AFATIT TË KONKURSIT, NUK DO TË SHOYRTOHEN.

Shpallja është e hapur që nga data 06.10.2022 deri më 20.10.2022

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Ndërmarrjes Publike Banesore në nr. tel. : 038 553 311.

Lumë's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Shullat, Rr. Bajram Kelmendi



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC COLA
Columbus, Georgia, USA
Since 1908